

**20192103288**

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TE  
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM – BANKA  
BOTËRORE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR POLITIKA ZHVILLIMORE  
PËR FINANCA PUBLIKE DHE KONKURRENCË**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore në shumë prej 125.000.000 eurosh, të dedikuar për realizim të politikave zhvillimore për financave publike dhe konkurrencë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua për politika zhvillimore për financa publike dhe konkurrencë, që do të lidhet ndërmjet Republikë së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 12 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej katër vitesh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmujor e zmadhuar për shtrirje fikse.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25 % të shumës së huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion në shumë prej 0,25 % nga pjesa e patërhequr e huas në nivel vjetor.

Huaja do të paguhet në 16 këste gjysmëvjetore secila në shumë prej 6,25 % të shumës së huas. Huaja do të paguhet më 15 maj dhe 15 nëntor çdo vit.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Ministria e Financave.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".